



04



Albania  
Investment  
Council

Improving Transparency and Investment Climate

# INCENTIVAT PËR NXITJEN E INVESTIMEVE: SHQIPËRIA PËRBALLË VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Tiranë, Prill 2016

**K**y dokument pune është përgatitur nga ekspertët e Sekretariatit të Këshillit të Investimeve në kuadër të mbledhjes V të Këshillit të Investimeve (27 prill 2016), z. Elvis Zerva, ekspert ligjor dhe znj. Ermelinda Xhaja, eksperte për ekonominë, nën drejtimin e Drejtores së Sekretariatit, znj. Diana Leka. Një kontribut të veçantë në përgatitjen e dokumentit kanë dhënë ekspertët e Agjencisë Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve (AIDA), znj. Mileva Meksi dhe z. Genc Celi. Mbështetje është ofruar nga znj. Elisa Lula, oficere administrative dhe komunikimit pranë Sekretariatit në organizimin e takimeve me partnerë dhe redaktimin gjuhësor të materialit. Falenderojmë drejtuesit e kompanive të huaja dhe vendase, institucionet (AIDA, BSH, MFE, INSTAT, QKB), ekspertët e pavarur, dhomat e tregtisë dhe shoqatat e biznesit (FIAA, AMCHAM, UCCIAL, DIHA, AREA) që kontribuan në analizën për stimulimin e investimeve në vend. Pikëpamjet e paraqitura janë të autorëve dhe jo domosdoshmërisht të Këshillit të Investimeve apo të BERZH-it.

## PËRMBAJTJA

|                                          |           |
|------------------------------------------|-----------|
| <b>HYRJE</b> .....                       | <b>4</b>  |
| <b>KONTEKSTI</b> .....                   | <b>6</b>  |
| <b>ANALIZA KRAHASUESE</b> .....          | <b>9</b>  |
| 3.1 Barra fiskale dhe Kosto e Punës..... | 9         |
| 3.2 Krahasimi i Incentivave.....         | 10        |
| <b>GJETJE</b> .....                      | <b>12</b> |
| <b>REKOMANDIME</b> .....                 | <b>17</b> |
| <b>SHTOJCA 1</b> .....                   | <b>20</b> |
| <b>SHTOJCA 2</b> .....                   | <b>21</b> |
| <b>SHTOJCA 3</b> .....                   | <b>30</b> |

# HYRJE

Pasojat e krizës globale u reflektuan në Vendet e Ballkanit Perëndimor pas vitit 2008 me rënien e ndjeshme të rritjes ekonomike, ku sipas të dhënave akoma nuk po arrin të rikuperohet në normën e përpara krizës (aktualisht vlerësohet vetëm në 2,1%<sup>1</sup> si mesatare e rajonit për 2015). Ndërkohë, rritja e dobët ekonomike e ka bërë më të vështirë konvergjencën e standardit të jetesës së rajonit me BE. Të ardhurat për frymë në vendet e Ballkanit Perëndimor, sipas paritetit të fuqisë blerëse janë pothuajse sa gjysma e vendeve të BE-së, dhe sa një e treta e vendeve jugore të BE-së dhe pothuajse sa një e katërta e vendeve më të pasura të BE-së (Sanfey, Milatovic, Kresic, 2016). Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor konsid-

erohen ende ekonomi në tranzicion<sup>2</sup>, të cilat kanë përjetuar një rritje të fluksit të investimeve të huaja direkte (IHD) për 2006 – 2014. Peshë mesatare e fluksit ndaj PBB-së, ka qenë e konsiderueshme kryesisht për Malin e Zi me 14%, për Shqipërinë me 8,2% dhe Serbinë me 7,7%. Ndërkohë, rajoni shikohet me shumë interes nga investitorët e huaj për avantazhet që mbart si: 1) perspektiva europiane; 2) stabiliteti makroekonomik; 3) vendndodhja gjeografike; 4) taksa të favorshme; 5) ekonomi të ndryshme; 6) kosto e lirë e punës, e kombinuar me 7) një popullsi relativisht të arsimuar<sup>3</sup>.

<sup>2</sup> Referuar të dhënave të Bankës Botërore luhaten në vlerën e të ardhurës për frymë, e vlerësuar për 2015, nga 4029 USD për Bosnia dhe Hercegovinë, në 4200 USD për Shqipërinë, 4900 USD për Maqedoninë, 5100 USD për Serbinë, në 6400 USD për Malin e Zi.

<sup>3</sup> Peter Sanfey, Jakov Milatović and Ana Krešić, January 2016, "How the Western Balkans can catch up" EBRD, Working Paper 186

<sup>1</sup> World Bank Group, South East Europe, Regular Economic Report, No.9 Spring 2016

Çështja që ngrihet për zgjidhje nga politikëbërësit dhe ekspertët është se cilat do të jenë burimet e rritjes në rajon? Një nga alternativat mbetet tërheqja e investimeve të huaja të qëndrueshme në rajon në përgjigje të avantazheve krahasuese të secilit vend. Ndaj, vendet e rajonit, përfshirë dhe Shqipërinë, kanë ndërmarrë politika nxitëse deri diku agresive, për të qenë sa më konkurruese në thithjen e investimeve të huaja. Por a janë të mjaftueshme vetëm këto incentive për të thithur investime produktive në ekonomi? Objekti i analizës në këtë dokument është të bëjë një evidentim të politikave të incentivave për investime në Shqipëri, në krahasim me vendet e tjera të rajonit, të sjellë këndvështrimin e investitorëve mbi këto politika, por edhe shqetësimet konkrete të tyre mbi klimën e të bërit biznes në vend. Analiza është ndër-

marrë në bashkëpunim dhe me kontributin e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA). Në konsideratë janë marrë raportet dhe studimet më të fundit të BERZH, OECD, GIZ, DIHA për klimën e investimeve dhe konkurrueshmërinë e Ballkanit Perëndimor dhe Shqipërisë në veçanti. Statistikat e shfrytëzuara për këtë analizë janë konsultuar edhe me Bankën e Shqipërisë, INSTAT, QKB<sup>4</sup>. Janë zhvilluar rreth 20 takime me përfaqësues të shoqatave të biznesit dhe kompani të mëdha që investojnë në Shqipëri, por edhe në vendet e rajonit.

<sup>4</sup> Matrica e Incentivave në Shtojcën 2 e konfirmuar edhe me Deloitte Albania


## KONTEKSTI

Shqipëria në rajon paraqitet ndër vendet me fluksin më të lartë të investimeve të huaja në pesë vitet e fundit, si në vlerë e renditur pas Serbisë dhe në


raport me PBB-në e renditur pas Malit të Zi (8,7% të PBB-së për 2014), siç tregohet në Figurën 1.

**aFigura 1: Fluksi i Investimeve të Huaja në vendet e Ballkanit Perëndimor**

a) në vlerë në milionë USD



b) në përqindje ndaj PBB-së



Burimi: Të dhëna të Bankës Botërore


Referuar Bankës së Shqipërisë (BSH), stoku i IHD-ve në Shqipëri në fund të vitit 2014 është i përqëndruar në: transport dhe komunikacion me rreth 27% të totalit, ndërsa shërbimi financiar me rreth 17%, dhe industria nxjerrëse me rreth 15%. Nga të dhënat e BSH, fluksi i IHD-ve për vitin 2015 llogaritet në 881 mln EUR, nga 869 mln EUR në 2014<sup>5</sup>. Ky fluks gjatë 2015, është përqëndruar në industrinë nxjerrëse 39%, energjetikë 35% dhe ndërmjetësim financiar 10%. Ndërsa për vitin 2014, fluksi i IHD-ve u përqëndrua në industrinë nxjerrëse me rreth 58% të vlerës, transporti dhe telekomunikacioni me rreth 13% dhe energjetika me rreth 9%. Ndërkohë, në vendet e rajonit panorama e shpërndarjes sektoriale të IHD-ve paraqitet më ndryshe. Ndërsa në Serbi, sektorët kryesorë të IHD-ve janë sektori financiar dhe industria përpunuese si automotive,

elektrike, ushqimore dhe tekstile. Në Maqedoni, vitet e fundit IHD-të janë në sektorin e industrisë automotive; në Bosnjë dhe Hercegovinë, sektorët me fluksin më të lartë janë industria, bankat dhe telekomunikacioni; ndërsa në Mal të Zi, sektori mbizotërues është turizmi. Një pjesë e mirë e fluksit të IHD-ve në rajon i dedikohet edhe privatizimeve të aseteve shtetërore, të cilat tashmë shikohen të ezauruara si mundësi për tërheqjen e investimeve të huaja.

Ekonomitë e rajonit paraqesin struktura të ndryshme, ku në Shqipëri ka një kontribut të rëndësishëm bujqësia në dallim nga vendet e tjera (Figura 2). Përsa i përket ecures së eksportit të të mirave dhe shërbimeve ndaj PBB-së (Figura 3), sërish Shqipëria mbetet pas Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi dhe krahasueshëm me Bosnjë-Hercegovinën.


<sup>5</sup> Publikimi i Bilancit të Pagesave për tre-mujor për vitin 2015 i Bankës së Shqipërisë

**Figura 2. Kontributi i sektorëve në % në PBB, 2014**



Burimi: Të dhëna të Bankës Botërore

**Figura 3. Eksporti i të mirave dhe shërbimeve (% PBB)**




Burimi: Të dhëna të Bankës Botërore

Në lidhje me strukturën e të mirave të eksportuara sipas nivelit të teknologjisë (Sanfey, Milatovic, Kresic, 2016), Shqipëria paraqet një diferencë të thellë me vendet e tjera, *ku 90% e të mirave të eksportuara janë kryesisht të profilit që kërkon intensitet të lartë pune dhe burime natyrore*. Mesatarja e Ballkanit për këtë kategori produktesh është në 50% të të mirave të eksportuara. Kjo përbën *një sfidë për konkurrueshmërinë* e vendit kundrejt rajonit, për të tërhequr industri me nivel më të lartë teknologjik dhe për të rritur vlerën e produkteve për treg të brendshëm dhe eksport. Ndërkohë, të dhënat e UNCTAD<sup>6</sup> flasin për një numër shumë të ulët të projekteve *Greenfield* në krahasim me vendet e rajonit, duke qenë të *fundit në fokus të projekteve të investitorëve të huaj* për 2013 dhe 2014 (Figura 4).

Nga të dhënat e fDiMarkets deri në gusht 2015, numri i projekteve për 2015 të njoftuara për Shqipërinë është 3 me vlerë investimi 118 mln USD dhe vende pune të krijuara 100.

**Figura 4. Të dhëna mbi Greenfield:**

**a) Numri i projekteve greenfield të njoftuara**



Burimi: UNCTAD


Vendet e rajonit, përfshirë Shqipërinë, kanë një kuadër ligjor mbështetës për trajtimin e investimeve dhe investitorëve të huaj. Ndërkohë, që janë ndër-marrë edhe një sërë politikash incentive për të tërhequr investitorë në sektorë dhe zona të caktuara. Por sa i rëndësishëm është ky kuadër ligjor dhe këto masa për të dhënë impakt në investime në vend?

*Incentivat e investimeve përkufizohen<sup>7</sup> si avantazhe*

<sup>7</sup> Sebastian James, "Investimet dhe incentivat fiskale dhe jo-fiskale: Evidenca dhe implikimet e politikave", Shërbimi Këshillues i

<sup>6</sup> UNCTAD që i referohet informacionit nga Financial Times Ltd, fDi Markets (www.fdimarkets.com)

**b) Vlera e projekteve greenfield të njoftuara (mln USD)**



Burimi: UNCTAD

*të matshme ekonomike që qeveritë u ofrojnë sipër-marrjeve të caktuara apo grupeve të sipër-marrjeve, me qëllim që të orientojnë investimet në sektorë apo rajone të caktuara ose të ndikojnë natyrën e këtyre investimeve. Këto përfutime mund të jenë fiskale (si lehtësim taksash) ose jo-fiskale (si grante, hua ose lehtësira rregullatore për të mbështetur zhvillimin e biznesit ose rritur konkurrueshmërinë).*

Klimës së Investimeve të Bankës Botërore (shtator 2013)

## ANALIZA KRAHASUESE

Qeveria Shqiptare po promovon në vazhdimësi sektorët prioritarë ku synon nxitjen e investimeve të huaja si: agro-biznes, energji, turizëm, TIK, industria e veshjeve dhe këpucëve, etj. Investimet në këto sektorë synohen edhe nga vendet e tjera të rajonit, duke qenë se shikohen si sektorë me potencial të vazhdueshëm në rritje dhe si mundësi reale për krijimin e vendeve të reja të punës. Në vende si Serbia dhe Maqedonia është arritur tërheqja e investimeve të rëndësishme në industrinë automotivë. Për më tepër, Shqipëria po promovon si mundësi investimesh nëpërmjet AIDA edhe sektorin e transportit (logjistikës) dhe Energjinë e rinovueshme në krahasim me Maqedoninë dhe Serbinë (Shtojca 1). Për të vlerësuar avantazhet në terma të incentiveve konkrete që ofrojnë vendet e Ballkanit Perëndimor është përgatitur një Matricë e Incenti-

vave e tyre, për secilin vend referuar faqeve zyrtare të agjencive qeveritare për nxitjen e investimeve, paraqitur në Shtojcën 2. Konkretisht, janë marrë në konsideratë disa aspekte si barra fiskale, lehtësirat fiskale, zonat ekonomike, lehtësira të tjera jo-fiskale, apo lehtësira për sektorë të caktuar, të përmblidhura si më poshtë.

### 1. BARRA FISKALE DHE KOSTO E PUNËS

Në lidhje me ngarkesën totale të taksave për biznesin, Shqipëria duket më pak tërheqëse në krahasim me vendet e tjera të rajonit, duke qenë se renditet vetëm pas Serbisë për shkallën më të lartë të tatimit mbi fitimin, tatimit në buirim dhe kontributit social të punëdhënësit. Të dhënat konfirmohen edhe nga Banka Botërore, nëpërmjet treguesit të normës totale të taksës (% e fitimeve komerciale) si në tabelën më poshtë:

**Tabela 1. Norma totale e taksës (% e fitimeve komerciale)**

| Vendet\Viti | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015              |
|-------------|------|------|------|------|------|------|-------------------|
| ALB         | 43.6 | 40.3 | 38.3 | 38.5 | 31.5 | 31.4 | 36.5 <sup>8</sup> |
| BIH         | 25.9 | 22.2 | 23.6 | 23.6 | 22.2 | 23.3 | 23.3              |
| KSV         | 28.3 | 16.5 | 15.8 | 15.6 | 15.4 | 15.4 | 15.2              |
| MKD         | 13   | 8.1  | 7.5  | 7.4  | 7.4  | 8.3  | 12.9              |
| MNE         | 29.9 | 29   | 24.4 | 21.6 | 21.6 | 21.6 | 21.6              |
| SRB         | 31.2 | 33.3 | 33.3 | 33.3 | 33.2 | 38.6 | 39.7              |

Burimi: Të dhëna të Bankës Botërore

<sup>8</sup> Barra tatimore prej 36,5 % përbëhet nga 14,1% tatimi mbi fitimin, 18,8% tatimi mbi pagën dhe 3,8% taksat dhe tatimet e tjera;

Nga ana tjetër Shqipëria është e krahasueshme me Kosovën dhe B&H për pagën minimale, por paraqet diferencë të dukshme në pagën mesatare, duke e bërë vendin tërheqës për koston e ulët të punonjësve relativisht të kualifikuar. Nga takimet me bizneset, por edhe nga disa anketime rezulton mungesa e fuqisë

punëtore të kualifikuar dhe certifikuar për procese teknologjike specifike si p.sh. në projekte në fushën e industrisë (naftë, gaz, TAP, etj.), projekte të cilave nuk iu është paraprirë me investime nga ana e shtetit, në shkollimin dhe përgatitjen profesionale të specialistëve të mirëfilltë.

Tabela 2. Kosto Mujore e Punës për Punëdhënësin në EUR

|                                        | ALB <sup>9</sup> | MKD        | SRB        | MNE        | KSV        | BIH        |
|----------------------------------------|------------------|------------|------------|------------|------------|------------|
| Paga minimale bruto                    | 157              | 200        | 226        | 288        | 170        | 164        |
| Paga mesatare bruto                    | 357              | 530        | 500        | 739        | 360        | 424        |
| Kontributi social i punëdhënësit       | 16.7%            | 0.0%       | 17.9%      | 10.0%      | 5.0%       | 10.5%      |
| <b>Kosto e punës për pagë minimale</b> | <b>183</b>       | <b>200</b> | <b>266</b> | <b>317</b> | <b>179</b> | <b>181</b> |
| <b>Kosto e punës për pagë mesatare</b> | <b>417</b>       | <b>530</b> | <b>590</b> | <b>813</b> | <b>378</b> | <b>469</b> |

Burimi: Zyrat statistikore respektive. Tabela është përpunim i Sekretariatit

2. KRAHASIMI I INCENTIVAVE

a. Incentivat fiskale

Vendet janë të krahasueshme në lehtësirat fiskale që ofrojnë, për importin e makinerive dhe lëndëve të para. Serbia dhe Bosnja ofrojnë edhe lehtësim në tatim fitim të lidhur me tregues specifike të shumës së investimit dhe numrit të punonjësve. Në lidhje me *mbartjen e humbjeve fiskale si pjesë e incentivave fiskale*, Shqipëria ofron mundësinë e mbartjes për 3 vjet të humbjeve, megjithëse modelet në rajon janë të ndryshme. Kemi vende që nuk ofrojnë mbartje, por edhe vende që ofrojnë nga 5 deri në 7 vjet si Serbia dhe Kosova. Mbartja e humbjeve bëhet veçanërisht e rëndësishme për investimet *Greenfield*, që paraqesin projekte investimi të shtrira në kohë, të cilat kërkojnë disa vite të gjenerojnë fitime. Shqipëria

paraqet disavantazh ndaj vendeve të rajonit, për-sa i përket *ri-investimit të fitimit*, duke e tatuar me 15%. Ndërkohë disa vende, e kanë më të ulët si normë ose nuk e aplikojnë ndaj pjesës së fitimit të ri-investuar, si rasti Maqedonisë dhe Serbisë kundrejt disa garancive paraprake për investime kapitale dhe hapjen e vendeve të reja të punës. Ky tatim, është konsideruar edhe nga bizneset, si një element që kombinuar me klimën e biznesit frenon investimin e fitimeve në vend dhe motivon transferimin e tyre jashtë për investitorët e huaj.

b. Zonat ekonomike

Zonat ekonomike në Shqipëri, Maqedoni dhe Serbi janë të organizuara në nivel kombëtar. Ndërsa Kosova dhe Bosnja mundësojnë krijimin dhe zhvillimin e zonave ekonomike edhe nga organet e pushtetit në nivel lokal. Aktualisht,

Shqipëria nuk ka asnjë zonë aktive në dallim nga Serbia, që ka 12 zona në aktivitet dhe Maqedonia 6 të tilla.

Në lidhje me incentivat fiskale, vendet janë konkurruese në raport me njëra-tjetrën. Sipas ligjit të TEDA-ve, Shqipëria ofron edhe incentiva jo-fiskale, për nxitjen e punësimit duke rritur shpenzimet e njohura, për kualifikimin e personelit dhe kërkim & zhvillimi.

c. Incentiva jo-fiskale

Shqipëria nëpërmjet miratimit të ligjit për investime strategjike, ofron një asistencë dhe procedurë të përshpejtuar nga AIDA, për investitorët strategjikë sipas përcaktimeve ligjore. Serbia në dallim nga vendet e tjera ofron një skemë më komplekse grantesh nga 150.000 EUR – 600.000 EUR dhe reduktim të kontributit social në varësi të natyrës së investimit, numrit të punonjësve dhe zonave ku do investohet. Kjo skemë është e aplikueshme si për investitorë vendas ashtu edhe të huaj.

d. Incentiva sektoriale

Megjithëse është e vështirë të kemi një listë të plotë të të gjitha incentivave në ligjet sektoriale, nga diskutimet me AIDA dhe aktorë të tjerë njihen disa forma incentivash sektoriale, si paketa fason, fond mbështetje për NVM-të, programet për bizneset *start-up*, fondi i punësimit apo subvencionet në bujqësi. Nga takimet me biznesin, shumë pak prej tyre kanë aplikuar për ndonjë incentivë të caktuar dhe gjykojnë se fondet janë shumë të limituara ose ka mungesë besimi në shpërndarjen e drejtë të përfitimeve, si p.sh. fondi i punësimit nga industritë e profilit që kërkojnë intensitet të lartë pune. Ndërkohë në rajon, Maqedonia dhe Mal i Zi, ofrojnë incentiva fiskale dhe subvencione të dedikuara për sektorin e turizmit, të cilat në kushtet kur edhe infrastruktura turistike e këtyre vendeve është më e kompletuar, avantazhet për tërheqjen e investitorëve në këtë sektor bëhen më të larta.

9 Për Shqipërinë, paga mesatare mujore i referohet sektorit publik për 2014.



# GJETJE

**N**dër argumentet më të forta të Shqipërisë sot në tërheqjen e investimeve të huaja, përmenden pa diskutim pozita e favorshme gjeografike, e cila paraqet potencial të lartë për zhvillim të investimeve në vend, kryesisht atyre me natyrë rajonale. Portet detare konsiderohen si një avantazh i rëndësishëm në lidhje me vendet e tjera të rajonit, sa i përket mundësisë së lidhjes me tregjet ndërkombëtare.

Shqipëria rezulton një ndër vendet me koston sociale më të ulët në rajon, edhe për shkak të pagës më të ulët në krahasim me vendet e tjera të Evropës Juglindore. Kjo në një farë mënyre reflekton nivele relativisht të ulta të produktivitetit të punës, që ende karakterizojnë vendin, por nga ana tjetër përbën një faktor nxitës për tërheqjen e investimeve të huaja.

Ndërkohë, trendi i krahut të punës së kualifikuar (krahasuar me popullsinë në moshë pune) është në rritje dhe përfaqëson një burim të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik. Përmirësimi i performancës së krimit të vendeve të reja të punës, është një tjetër tregues progresi i tregut të punës në Shqipëri.

Përgjatë vitit të fundit reflektohet një rritje e

shëndetshme ekonomike, ardhur kjo si pasojë e një sërë reformash të reja orientuar nga modeli i ri makro-ekonomik. Falë zbatimit të reformës makro-ekonomike dhe stabilitetit fiskal, Shqipëria nuk është më pjesë e hartës së riskut makroekonomik. Të dhënat tregojnë një rritje progresive të IHD-ve. Në periudhën janar - shtator 2015, fluksi i IHD-ve, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës është rritur me 15,7% ose e shprehur në vlerë është rritur me 100 Milionë EUR.

## 1. LEGJISLACIONI ME OBJEKTIVA AMBICIOZE PËR THITHJEN E INVESTIMEVE TË HUAJA

Shqipëria ka adoptuar një legjislacion liberal në fushën e investimeve për të mundësuar rritjen e investimeve të huaja direkte. Legjislacioni në fuqi nuk diskriminon investitorët e huaj, ndërsa politikat tatimore nuk bëjnë dallim midis investimeve vendase dhe të huaja duke i vendosur investitorët në kushte të barabarta. Në vitin e fundit është miratuar edhe ligji “Për Investimet Strategjike”, që mundëson ligjërisht që investimet e huaja në sektorët më të rëndësishëm të lëvizin me shpejtësi dhe të shmangin pengesat e shumta jo-

produktive dhe administrative që dalin përpara investitorëve. Për këtë arsye është parashikuar që AIDA, të luajë një rol më aktiv duke shërbyer si agjent i investitorit strategjik, përpara të gjitha institucioneve të tjera të administratës publike. Qëllimi i miratimit të ligjit është nxitja e fluksit të investimeve të rëndësishme në ekonomi deri më 31 dhjetor 2018, ndërkohë që në fund të vitit 2015, ligji u kompletua edhe me aktet përkatëse nënligjore të cilat janë miratuar<sup>10</sup>. Ligji i ri “Për Zonat Ekonomike” (TEDA) renditi një sërë incentivash fiskalë, administrative dhe ligjore<sup>11</sup>. Për më tepër, Qeveria ka miratuar edhe ligje sektoriale, siç janë Ligji 93/2015 “Për Turizmin”<sup>12</sup>, Ligji 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” të cilat kanë si qëllim nxitjen e investimeve në këto sektorë. Duke patur në konsideratë sa më sipër, kuadri ligjor specifik për investimet e huaja mund të konsiderohet si i stabilizuar. Shtojca 3 bën një panoramë të detajuar të legjislacionit kryesor për investimet në vend.

Në krahasim edhe me vendet e rajonit konstatohet se paketa e ligjeve dhe e akteve nënligjore është ambicioze, serioze dhe me objektiva strategjike<sup>13</sup>. Megjithatë, ende nuk ka një rast konkret të një investitori strategjik të shpallur si të tillë apo një zhvillues i TEDA. Aktualisht numërohen dy projekte investimi strategjik të

<sup>10</sup> 9 VKM të nxjerra në bazë dhe për zbatim të Ligjit Nr. 55/2015

<sup>11</sup> Incentivat në Ligjin Nr. 9789 datë 19.07.2007 (i ndryshuar) janë përcaktuar kryesisht në Nenin 13 të tij. Këtu mund të bëhen disa vërejtje lidhur me mënyrën jo shumë të thjeshtë të përcaktimit të këtyre incentivave, të cilat e bëjnë të vështirë promovimin e tyre në praktikë tek investitorët e huaj. Pavarësisht kësaj, ky është ligji i vetëm i cili në mënyrë konkrete parashikon një numër incentivash të unifikuara në një drejtim të caktuar.

<sup>12</sup> Pritet dalja e VKM zbatuese të Ligjit

<sup>13</sup> Ligji për Investimet Strategjike targeton kategori të investitorëve potencialë në vlera të larta sipas sektorëve të shpallur strategjikë Kufijtë minimalë monetarë të investimeve të propozuara janë të tilla të cilat synojnë rritje të menjëhershme të fluksit të investimeve të huaja në vend. Për më shumë detaje referoju Shtojcës 3.

cilat kanë aplikuar pranë AIDA, për statusin e investitorit strategjik. Incentivat e përcaktuara në legjislacion nuk kanë rezultuar për momentin në një tërheqje masive dhe të rëndësishme të investimeve të huaja. Sekretariati zhvilloi takime me investitorë që ushtrojnë aktivitetin në fusha të ndryshme të ekonomisë në Shqipëri dhe rajon, të cilët vlerësuan pozitivisht përgatitjen e kuadrit ligjor, por nënvizuan skepticizmin e tyre lidhur me efektivitetin e këtij kuadri ligjor (kufijtë minimalë monetarë të investimeve të propozuara për t’u konsideruar si strategjike janë ambiciozë, por të vështirë për t’u plotësuar). Për pasojë nuk do të jetë e lehtë tërheqja e investimeve startegjike në vend. Megjithatë, duke patur në konsideratë kohën e shkurtër të zbatimit të legjislacionit të mësipërm, vlerësohet se është ende herët për të përcaktuar efikasitetin ose jo të këtyre iniciativave ligjore.

## 2. INCENTIVAT DHE LEGJISLACIONI FISKAL I PAQËNDRUESHËM

Konkretisht, bizneset ngrenë çështje dhe shqetësime që lidhen me klimën e përgjithshme të biznesit me fokus në elementet e korrupsionit, mungesën e kapaciteteve administrative dhe dyshimi për ndryshimet e shpeshta në paketën fiskale. Nga intervistat e kryera me disa biznese, mungesa e *parashikueshmërisë fiskale* theksohet si një disavantazh, me vendet e rajonit për investime në vend. Në përgjithësi është pranuar se ligji i TEDA-ve, ka renditur një sërë lehtësish fiskale<sup>14</sup> të rëndësishme për zhvilluesin dhe përdoruesit në TEDA. Megjithatë paqëndrueshmëria fiskale në vend dhe veçanërisht skepticizmi mbi mënyrën si administrata në përgjithësi, dhe ajo

<sup>14</sup> Në nenin 13 të Ligjit Nr. 9789 datë 19.07.2007 parashikohen shprehimisht 10 incentiva/lehtësi fiskale.

tatimore në veçanti, zbatojnë legjislacionin<sup>15</sup>, mund të vështirësojnë zbatimin e incentivave në praktikë<sup>16</sup> dhe të dëmtojnë qëllimin pozitiv të ligjit. Angazhimet e fundit publike të Qeverisë për ndryshime ligjore, të cilat synojnë thjeshtimin e procedurave për bizneset dhe jo ndryshime në paketën fiskale, janë konsideruar si mjaft inkurajuese.

### 3. PERIUDHA NË DISPOZICION PËR MBARTJEN E HUMBJEVE FISKALE ËSHTË E SHKURTËR

Referuar Matricës Krahasuese të Incentivave (Shtojca 2), evidentohet një dallim midis Shqipërisë dhe vendeve të tjera të rajonit<sup>17</sup>, në lidhje me periudhën në të cilën bizneset mund të mbartin humbjen fiskale. Legjislacioni tati-mor shqiptar parashikon se bizneset mund të mbartin humbjet e tyre fiskale për një periudhë 3 vjeçare. Ndërsa në vendet e tjera (me përjashtim të Maqedonisë), bizneset mund të mbartin humbjet fiskale për një periudhë nga 5 deri në 7 vjet. Bizneset e kontaktuara nga Sekretariati theksuan se periudha e shkurtër prej 3 vjet për humbjet tatimore në Shqipëri, penalizon investimet e reja sidomos investimet “*Greenfield*” apo

<sup>15</sup> Lidhur me problematikat në fushën tatimore përfshirë kuadrin ligjor dhe atë të administrimit, Sekretariati është ndalur më herët në mënyrë të detajuar në Dokumentat e Punës: “Propozime për Përmirësimin e Procesit të Kontrollit Tatimor në Shqipëri” (shtator 2015), “Informaliteti: Sfidë e Përbashkët Qeveri-Sipërmarrje” (dhjetor 2015) dhe “Për Përmirësimin e Mekanizmave të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve midis Biznesit dhe Administratës Publike” (shkurt 2016). <https://www.investment.com.al/sq/kalendari-i-mbledhjeve-2015>

<sup>16</sup> Në Ligjin Nr. 9789, Nenin 13 “Lehtësitë fiskale” paragrafi 1 pika b) parashikohet si lehtësi fiskale: “zhvilluesit dhe përdoruesit përjashtohen nga pagesa e 50 përqindëshit të normës së tatimit për 5 vitet e para, nga fillimi i veprimtarisë së tyre në zonë”. Në kushtet e ndryshimit potencial (rritjes) së normës së tatimit fitimit të korporatave si rezultat i ndryshimeve në paketën fiskale, edhe kjo incentivë nuk konsiderohet garanci e plotë nga investitorët.

<sup>17</sup> Të njëjtin afat 3 vjeçar të mbartjes së humbjeve fiskale e ka edhe Maqedonia. Ndërsa në të gjitha vendet e tjera parashikohet një afat më i gjatë për mbartjen e humbjeve fiskale.

investime të ngjashme të cilat kanë një afat fill-estar investimi prej më shumë se 3 vjet. Periudha për investimet “*Greenfield*”, për të gjeneruar fitime është nga 3-5 vjet apo edhe më shumë, në varësi të aktivitetit. Në këto raste mundësia për të përfutur përdorimin e humbjeve fiskale nga vitet e mëparshme është thelbësore për këto biznese, në mënyrë që këto humbje të mbartura të kompensohen me fitimet e pritshme nga këto lloj biznesesh.

### 4. MUNGOJNË PRODUKTET PËRFUNDIMTARE PROMOVUESE PËR INVESTIME NË SEKTORË PRIORITARË DHE KONKURRUES

#### a. Nuk disponohet një inventar sistematik i të gjitha incentivave sektoriale

Sekretariati nuk ka arritur që të identifikojë një listë shteruese të të gjitha incentivave, të ndarë dhe sipas sektorëve specifikë që të jetë e publikuar apo në dispozicion të investitorëve sipas interesit të tyre konkret. AIDA nuk ka arritur akoma që ta plotësojë këtë listë të plotë megjithë përpjekjet e vazhdueshme të saj, për t’u pajisur me këtë informacion nga ministritë e linjës.

#### b. Nuk ka studime fizibiliteti në nivele sektoriale që t’u ofrohen paraprkisht investitorëve të huaj

Investitorët që nuk vijnë me plane konkrete investimi, duhet t’u vihen në dispozicion studime fizibiliteti dhe projekte konkrete sektoriale. Referuar takimeve të Sekretariatit me dhomat e tregtisë është vënë theksi tek interesi për investime në turizëm, por kërkohet që Qeveria të ofrojë një studim, një paketë promovuese të paktën në një zonë pilot për t’i adresuar investitorët, ose një re-

gjistër të zonave me prioritet zhvillimi në turizëm (në zbatim të ligjit të ri për turizmin). AIDA duhet të ketë një listë të plotë të aseteve shtetërore të lirë nga problemet e pronësisë për t’u vendosur në dispozicion të investorëve, ashtu si dhe listë projektesh konkrete shtetërore që kërkojnë financim nga investitorë. Këto informacione do të ndihmonin AIDA, për të promovuar më së miri mundësitë që ofrohen për investim.

#### c. Avantazhi që sjell pozita gjeografike e vendit në raport me vendet e tjera të rajonit nuk po shfrytëzohet si duhet

Pozita gjeografike e Shqipërisë konsiderohet si një avantazh i rëndësishëm në lidhje me vendet e tjera të rajonit, sa i përket mundësisë së lidhjes me tregjet ndërkombëtare. Pavarësisht kostove më të ulëta të shërbimit, kapacitetet e përpunimit në infrastrukturën portuale në vend mbeten sërish të kufizuara si rezultat i thellësisë së ulët dhe i pamundësisë kësaj për të ofruar shërbime përpunimi për anije të tonazhit të lartë. Nga ana tjetër, bizneset operuese në fushën e transportit nënvizojnë nevojën për investime të qëndrueshme në infrastrukturën portuale dhe respektim të kontratave konçesionare. Gjithashtu evidentohen problematika sa i përket kohës së përpunimit, aspekteve procedurale dhe burokratike, të cilat vonojnë qarkullimin e lirë të mallrave. Sistemet e inteligjencës për kontroll risku në autoritetet doganore, duhet të funksionojnë për të mos krijuar pengesa dhe vonesa të paarsyeshme në transportin e mallrave. Sikurse është evidentuar edhe më herët nga Sekretariati, komisionet për skanimin e mallrave prej 22 EUR/deklaratë doganore kanë sjellë një rritje të kostove për bizneset duke konsideruar rrugë të tjera transporti për bizneset e rajonit, të cilat kalojnë tranzit mallrat e tyre nëpërmjet Shqipërisë.

### 4. INSTITUCIONE DHE ADMINISTRATË PROFESIONALE SI PARAKUSHT PËR PËRGATITJEN DHE ZBATIMIN NË PRAKTIKË TË INCENTIVAVE

Në takimet e zhvilluara nga Sekretariati me bizneset e veçanta dhe shoqatat e biznesit u nënvizua se: “*incentivat janë tregues të rëndësishëm për tërheqjen e investimeve të huaja, por nuk janë faktori vendimtar mbi bazën e të cilëve investitorët vendosin të kryejnë investime në vend*”. Shqetësime u shprehën nga sektori privat lidhur me sa më poshtë:

#### a. Institucionet dhe administrata, jo gjithmonë me frymë pozitive ndaj biznesit

Me gjithë përmirësimet e kryera, bizneset kanë ankesa të vazhdueshme për burokraci të tepërt të administratës dhe për performancë të ngadaltë dhe larg ritmit të kërkuar prej tyre. Ka mjaft raste të vonësive në përgjigjet ndaj bizneseve, apo pyetje të bizneseve të cilat ngelen pa përgjigje nga administrata. Mungesa e transparencës dhe interpretime të diskutueshme diskrecionare të ligjeve dhe akteve nënligjore nga ana e autoriteteve kompetente, perceptohet nga bizneset si një tregues i fortë i korrupsionit. Një nga çështjet kryesore që u ngrit nga bizneset e intervistuar janë marrëdhëniet me administratën publike, e cila duhet të jetë më e ndjeshme ndaj nevojave të biznesit, më e përgjegjshme dhe e gatshme për bashkëpunim dhe informacion.

#### b. Mungesa e koordinimit midis institucioneve - barrë për bizneset

Në mënyrë të përsëritur, sektori privat thekson me forcë mungesën e shkëmbimit të informacionit midis administratës tatimore dhe asaj doganore, që përkthehet në kosto për bizneset.



Bizneset vlerësojnë se duhet të ulet barra administrative nëpërmjet uljes së numrit të deklarave dhe vërtetimeve që i kërkojnë bizneseve. Informacioni i shkëmbyer midis administratës tatimore dhe asaj doganore duhet të bëhet elektronikisht dhe jo t'i lihet biznesit barra për të vërtetuar aktet e administratës. Udhëzimi i TVSH-së<sup>18</sup> parashikon disa burokraci të tepruara në lidhje me specifika të caktuara për transportin ndërkombëtar që trajtohet si shërbim me 0% TVSH. Konkretisht, operatorët në fushën e transportit ndërkombëtar, për të vërtetuar kryerjen e shërbimeve të transportit me 0% TVSH, në bazë të udhëzimit duhet që të disponojnë një numër të madh vërtetimesh, autorizimesh dhe regjistrimesh, si dokumenta justifikues për qëllime tatimore. Ndërkohë, mungesa qoftë edhe e njërit prej këtyre dokumentave, marrja e të cilave nuk varet vetëm nga operatori i transportit, por edhe nga tatimpaguesi i huaj i vendosur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (ku p.sh.

disa lloj vërtetimesh mund të mos lëshohen nga institucionet e vendit të huaj sipas formatit të kërkuar nga udhëzimi), rrezikon njohjen e shërbimit të transportit si të tatueshëm me 20%. Kjo krijon vështirësi administrative për biznesin, duke konsideruar volumin e operacioneve me biznese vendase dhe të huaja, si edhe e ekspozon atë ndaj kostove të tjera.

### C. Mungesa e ndërsjelltë e transparencës dhe e bashkëpunimit administratë-biznes

Në takimet e shumta të Sekretariatit me sektorin privat, vazhdon të ndihet nga ky i fundit një klimë mosbesimi ndaj administratës publike dhe mungesë vullneti për konsultim dhe bashkëpunim. Bizneset kërkojnë më shumë fleksibilitet dhe mirëkuptim nga administrata, kryesisht transparencë në veprimet e saj dhe mundësisht përfshirje paraprake në hartimin e akteve nënligjore të cilat kanë impakt direkt mbi to.

## REKOMANDIME

### REKOMANDIM 1.

#### MBI INCENTIVAT

1. AIDA me mbështetjen e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes (MZHE/TTS) dhe në koordinim me ministrinë e linjës të përgatisë një inventar të gjithë incentivave që ofron legjislacioni shqiptar mbi investimet dhe sektorët për t'u publikuar në faqen e saj të internetit.
2. Të vlerësohet nga Ministria e Financave në diskutim me grupet e interesit, mundësia për të mos tatuar atë pjesë të fitimit që planifikohet nga bizneset për ri-investime, si një masë e kërkuar nga bizneset dhe që shikohet si nxitëse për investitorët aktualë, vendas dhe të huaj. Dhënia e incentiveve fiskale për ri-investimet, është një praktikë

e njohur ndërkombëtare. Nëse një biznes apo një investitor i huaj, për vitin ushtrimor rezulton me fitim (aktualisht menjëherë i tatueshëm në masën 15%), do të ishte më i interesuar të ri-investonte dhe të zgjeronte aktivitetin, nëse shumat e ri-investuara nuk do të ishin objekt i taksave dhe tatimeve. Në lidhje me këtë, kërkohet një analizë e diskutim më i gjerë lidhur me efektet, mënyrën e zbatimit dhe kapacitetet e administratës dhe bizneseve për monitorimin e destinacionit të ri-investimeve. Të vlerësohet nga Ministria e Financave, në diskutim me grupet e interesit, *shtrirja e periudhës së mbartjes së humbjeve tatimore mbi 3 vjet*. Kjo do të jetë në favor jo vetëm për investimet fillestare me kapital të lartë, por do të kontribuojë edhe në rritjen e konkurrencës së Shqipërisë në tërheqjen e

<sup>18</sup> Udhëzimi Nr. 6 datë 20.01.2015 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar"

IHD-ve, duke pasur parasysh se vendet fqinje, vendosin në dispozicion të bizneseve për këtë qëllim, një periudhë minimale prej 5 vjetësh.

3. Për sektorët të cilët kërkojnë intensitet të lartë pune si BPO<sup>19</sup>, ku ka lëvizje të shpeshta të punonjësve dhe kosto të larta për trajnimin e tyre fillestar, të vlerësohen nga Ministria e Punës, ndërhyrjet ligjore për të mundësuar që sipërmarrësit në këtë sektor, *të mos paguajnë kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për muajin e parë (periudha e trajnimit)*, si dhe për punonjësit e ardhur rishtaz. Kjo kosto të përballohet nga shteti, si një incentivë direkte për këtë sektor që vlerësohet se krijon një xhiro rreth 500 milion EUR<sup>20</sup> (rreth 5% e PBB-së) dhe një numër të punësuarish rreth 40 mijë vetë, kryesisht të rinj të sapodiplomuar. Mbështetje nga AIDA për promovimin e sektorit të BPO-ve, në tregjet ndërkombëtare është e vlerësueshme. Nga ana tjetër, shteti mund të vendosë në dispozicion të këtyre sipërmarrjeve ambiente dhe ndërtesa të cilat i disponon, me qëllim shfrytëzimin e tyre për qëllime trajnimi, zhvillimi të stafit, etj.
4. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale ashtu si dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit të vendosë në dispozicion të AIDA-s, *skemat e qarta të formave mbështetëse* që shteti ofron për investitorët (sipas sektorëve të investimit). Skemat aktuale funksionojnë në bazë aplikimi. AIDA duhet të jetë e mirë-informuar mbi procedurat.
5. *Përgatitja e produkteve promovuese sektoriale dhe studimeve të fizibilitetit* nga AIDA

me mbështetjen e MZHETTS, duke filluar paraprakisht me zona pilot ose sektorë pilot. Një sektor që paraqet interes të veçantë dhe kërkon angazhim nga shumë institucione, për përgatitjen e një produkti promovues është industria automotive. Interesi i kësaj industrie lidhet me disa arsye si trendi i projekteve të investimeve në rajon në vitet e fundit, avantazhet që ofron Shqipëria në krahun e lirë të punës, afërsisë me tregjet europiane, përjashtimi i taksave për eksport, etj. Ndaj kërkohet dhe finalizimi sa më shpejt i bazës së të dhënave dhe dosjeve të plota të pronave shtetërore, si dhe i studimeve të fizibilitetit për t'u vendosur në dispozicion të AIDA-s.

6. *Përmirësimi i informacionit të ofruar nga AIDA*, nëpërmjet faqes së internetit për investitorët—kryesisht ofrimi i të dhënave sektoriale dhe një baze të dhënash me listën e vendeve/ambiente konkrete për investime. Rritja e burimeve në dispozicion të AIDA, në funksion edhe të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin prej ligjit “Për Investime Strategjike”.
7. Të konkretizohet *kontributi i Ministrive për të vënë në dispozicion të AIDA-s periodikisht burimet*.
  - » Në përgatitjen e një *inventari të të gjithë incentivave* që ofron legjislacioni shqiptar mbi investimet dhe sektorët për t'u publikuar në faqen e saj të internetit.
  - » MZHETTS duhet të vërë në dispozicion *bazën e integruar të të dhënave mbi asetet publike* nën administrim të saj, me qëllim promovimin e mundësive për investim nga AIDA.
  - » Ministrinë e linjës duhet të vënë në dispozicion *të dhëna sektoriale*, me qëllim hartimin e broshurave informuese dhe

promovuese sektoriale nga AIDA.

- » Ministrinë e linjës duhet të vënë në dispozicion *informacion mbi projekte konkrete investimi*, mbi të cilat secila ministri është iniciatore apo përgjegjëse, me qëllim promovimin e këtyre projekteve tek investitorë të cilët nuk vijnë me plane konkrete investimi.
  - » Secila ministri (apo institucion varësie kompetent) duhet t'i mundësojë AIDA-s *informacion të detajuar mbi të gjitha hapat dhe hallkat administrative* (leje/licenca/autorizime), të cilat nevojiten për të realizuar një investim sipas sektorit nën kompetencë. Ky informacion nevojitet që të krijohet një flow-chart të qartë për secilin sektor (afate, procedura, leje). Ky “*flow chart*” i vjen në ndihmë jo vetëm zbatimit të LIS por e shndërron AIDA-n në një “dritare unike” dhe për investimet jo-strategjike pasi disponimi i një harte të qartë procedurash dhe dokumentacioni për çdo sektor i vjen në ndihmë çdo investimi. Për më tepër, analizimi i këtij flow-chart në një moment të dytë, i jep mundësinë AIDA-s së bashku me institucionet e tjera kompetente, për të identifikuar problematika dhe për të sugjeruar rekomandime.
8. *Parashikime ligjore për t'u krijuar mundësinë efektive bashkive* të reja në kuadër edhe të *reformës administrative-territoriale*, për të hartuar dhe zhvilluar zonat e tyre ekonomike në varësi të aseteve dhe burimeve që disponojnë. Rekomandohet që autoritetet lokale të zbatojnë detyrimin për raportim periodik (një herë në 6 muaj) mbi listën e aseteve/zonave nën administrim të tyre tek MZHETTS. Ky proces ndihmon përditësimin e regjistrit në nivel kombëtar.

## REKOMANDIM 2.

### MBI KLIMËN E INVESTIMEVE

9. *Një rishikim themelor i legjislacionit* tatimor me qëllim reduktimin e burokracive dhe stabilizimin e tij është një kërkesë e vazhdueshme e biznesit, por edhe një sipërmarrje që kërkon një kompromis politik. Konsultimi dhe përfshirja e mendimeve të biznesit që në hapat e parë të hartimit për paketën fiskale është domosdoshmëri. Sikurse është nënvizuar edhe më herët nga Sekretariati, Ligji nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” duhet të zbatohet me përpikmëri nga administrata. Ndryshimi i frymës së administratës sidomos asaj tatimore dhe doganore në marrëdhëniet me biznesin rrit besimin tek institucionet.
10. *Pronësia* mbetet problem për ata që duan të investojnë dhe kërkojnë sipërfaqe të mëdha të lira, sidomos në bujqësi dhe turizëm. Rekomandohet nga bizneset, për shkak të interesit të lartë që kanë investitorë të huaj të fuqishëm, krijimi i zonave pilot për investime në turizëm me plane zhvillimore ekonomike dhe urbanistike.
11. *Krahu i punës* megjithëse është i lirë, rendimenti është shumë i ulët në krahasim me vendet e rajonit. Duhet t'i jepet prioritet zhvillimit të forcës së punës, sidomos në sektorët që kanë potencial si turizmi, hidrokarbure, burime natyrore. Krijimi i forcës punëtore të kualifikuar dhe të certifikuar për procese teknologjike specifike, kërkon investime nga ana e shtetit në shkollimin dhe përgatitjen profesionale të specialistëve të mirëfilltë—një hap i domosdoshëm për t'i paraprirë projekteve të mundshme strategjike.

19 Nënkontraktimi i proceseve të biznesit [ang: business process outsourcing]

20 Referuar nga Albania Outsourcing Association (ADA)

# SHTOJCA 1

Sektorët Prioritarë të Agjencive Promovuese të Investimeve

| Shteti                          | Bosnja | Bullgaria | Kroacia | Shqipëria | Kosova | Maqedonia e Veriut | Mali i Zi | Serbia |
|---------------------------------|--------|-----------|---------|-----------|--------|--------------------|-----------|--------|
| Agrikulturë/ Industri Ushqimore | Y      | Y         | Y       | Y         | Y      | Y                  | Y         | Y      |
| Automotive                      | Y      |           | Y       |           | Y      | Y                  |           | Y      |
| Shërbime Biznesi                |        | Y         |         |           | Y      |                    |           | Y      |
| Industri Kimike                 |        | Y         |         |           |        |                    |           |        |
| Ndërtim                         | Y      |           |         |           | Y      |                    |           |        |
| Elektronikë                     |        | Y         |         |           |        | Y                  |           | Y      |
| Energji                         | Y      |           |         | Y         | Y      |                    | Y         |        |
| Shërbime Financiare             | Y      |           |         |           |        |                    | Y         |        |
| Shëndetësi                      |        | Y         |         |           |        |                    |           |        |
| TIK                             | Y      | Y         | Y       | Y         | Y      | Y                  |           | Y      |
| Logjistikë                      |        | Y         | Y       | Y         |        |                    |           |        |
| Ndërtim makinerish              |        | Y         |         |           |        |                    |           | Y      |
| Përpunim Metalesh               | Y      |           | Y       |           |        |                    |           | Y      |
| Miniera                         | Y      |           |         | Y         | Y      |                    |           |        |
| Farmaceutikë                    |        |           | Y       |           |        | Y                  |           |        |
| Përpunim i gurëve dekorativë    |        |           |         |           | Y      |                    |           |        |
| Tekstile                        | Y      |           | Y       |           | Y      |                    |           | Y      |
| Turizëm                         | Y      | Y         | Y       | Y         | Y      |                    | Y         |        |
| Përpunim Ushqimor               |        |           |         |           | Y      |                    |           | Y      |

# SHTOJCA 2

Matrica krahasuese e incentivave për investime në vendet e ballkanit perëndimor

## 1. TË PËRBASHKËTA:

- 1. Marrëveshje të Tregtise se Lirë si CEFTA dhe EFTA
- 2. Marrëveshje të Shmangies së Taksimit të Dyfishtë me shumë shtete
- 3. Kuadër Ligjor për Investimet dhe Mbrojtjen e Investimeve te Huaja

| INCENTIVA                      | SHQIPËRIA | MAQEDONIA E VERIUT | SERBIA                                                                                                                                                  | MALI I ZI | KOSOVA | BOSNJA DHE HERCEGOVINA |
|--------------------------------|-----------|--------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|--------|------------------------|
| BARRA FISKALE                  |           |                    |                                                                                                                                                         |           |        |                        |
| Norma e Fitimit të Korporatave | 15%       | 10%                | 15%<br>Përgjashtim nga tatimi mbi fitimin për investitorët e mëdhenj që investojnë më shumë sesa 1 miliard RSD në asete dhe punësojnë mbi 100 punonjës. | 9%        | 10 %   | 10%                    |

| INCENTIVA                                     | SHQIPËRIA  | MAQEDONIA E VERIUT                                                                                                   | SERBIA                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | MALI I ZI                                                                                                                                                                                                                                                                          | KOSOVA                     | BOSNJA DHE HERCEGOVINA |
|-----------------------------------------------|------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------|------------------------|
| <i>Norma e tatimit në burim për interesat</i> | 15%        | 10% për jo rezidentët përveçse kur marrëveshja për eliminimin e tatimit të dyfishtë parashi-kon një normë më të ulët | Interesat e paguar jorezi-denteve janë subjekt i tatimit në burim prej 20% përveçse kur parashiko-het ndryshe në Marrëveshtjet për shmangien e tatimit të dyfishtë.                                                                                                                                                                  | 9% për kom-panitë jo rezi-dente dhe 5 % për individët jo rezident përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga marrëveshtjet për shmangien e tatimit të dyfishtë.                                                                                                                   | 10 %                       | 10 %                   |
| <i>Tatimi mbi të ardhurat personale</i>       | 0%/13%/23% | 10%                                                                                                                  | <ul style="list-style-type: none"><li>• Të ardhurat nga punësimi dhe të ardhurat nga biznesi 10%;</li><li>• Të ardhurat nga të drejtat e autorit dhe të ardhurat nga qiratë 20%;</li><li>• Të ardhurat nga kapitali 15% duke përjashtuar nga tatimi shitjet e aseteve që kanë qenë në pronësi të shitesit për mbi 10 vjet.</li></ul> | 9% për të ardhurat nga punësimi mbi 720 Euro neto/muaj, norma tatimore është 11% Për pagat e punonjësve të start up (përveç sektorit të agri-kulturës, pesh-kimit, transport, ndërtimit të anijeve) janë të përjashtuara nga tatimi per 8 vjet deri në shumën totale 200,000 Euro. | Progresive 0%/4%, 8%, /10% | 10%                    |
| <i>Kontributi social i punëdhënësit</i>       | 16,7%      | 0%                                                                                                                   | 17,9%                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | 10% Baza maksimale për kontributet është 50.000 EUR në një vit kalendarik.                                                                                                                                                                                                         | 5% + 10% vull-netare       | 10,5%                  |
| <i>Kontributi social i punëmarrësit</i>       | 11,2%      | 27%                                                                                                                  | 19,9%                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | 24%                                                                                                                                                                                                                                                                                | 5% + 10% vullnetare        | 31%                    |

| INCENTIVA                | SHQIPËRIA                           | MAQEDONIA E VERIUT                                                                                                                                      | SERBIA                                           | MALI I ZI                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | KOSOVA                                                                                                                                                                                                        | BOSNJA DHE HERCEGOVINA                    |
|--------------------------|-------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|
| <i>TVSH</i>              | 20%                                 | 18% normë standarte 5% normë e reduktuar (ushqime, kompjutera, programe kompjuterike, sisteme termike diellore, shitja e parë e ndërte-save të banimit) | 20% 10% për ush-qime bazike dhe shërbime publike | 19% Tatim-pa-guesit me të ardhura mbi 18.000 EUR është subjekt TVSH. 7% për ushqime bazë, barna, libra, sherbime publike dhe transport. 0% TVSH për transport ndër-kombëtar                                                                                                                                                                                                          | Norma stan-darde e TVSH-së është 18% për subjektet me te ardhura mbi 30.000 EUR. Aplikohet norma e reduktuar prej 8% për fur-nizimet e ush-qimeve bazëe brenda vendit dhe në import.                          | 17%                                       |
| <i>Humbjet Tatimore</i>  | Mbarten 3 vite rresht               | Humbjet mund të mbarten për 3 vite rresht                                                                                                               | Mbarten 5 vite rresht                            | Humbjet tati-more, përfshi humbjet kap-itale, mund të mbarten për 5 vite rresht.                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | Mbarten deri në 7 vite rresht                                                                                                                                                                                 | Humbjet mund të mbarten për 5 vite rresht |
| <i>Rimbursimi i TVSH</i> | I menjëhershëm ose nga 30 – 60 ditë | Rimbursimi i TVSH-së, bëhet menjëherë brenda 30 ditëve nga dorëzimi i deklaratës tatimore.                                                              |                                                  | Investitori i huaj nuk duhet të paguajë çdo po-rosi në mallrat e eksportuara, por ka për detyrë të paguajë TVSH-në shkallë 0%, sipas Ligjit për TVSH-në. Kjo do të thotë se investitori i huaj që ka paguar TVSH për lëndët e para dhe në momentin kur ai eksporton produkte të për-funduar nuk do të paguajë TVSH, duke pasur të drejtën për kompen-simin e TVSH për lëndët e para. | Çdo tre muaj për furnizime vendore nëse kreditimi është mbartuar 3 muaj rresht dhe në fund të mua-jit të tretë vlera e kreditimit ka-lon 3.000 EUR. Në eksporte çdo muaj, nëse kreditimi është mbi 3.000 euro |                                           |

| INCENTIVA KONKRETE |                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
|--------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1. Fiskale         | <p><b>Përrjashtuar nga TVSH në import:</b> 1. makineri dhe paisje bujqësore, makineri përpunim aktiv dhe agro-biznes; 2. makineri të dedikuara për investime ≥ 360.000 EUR</p> <p><b>Përrjashtim taksa doganore</b> importin e lëndëve të para dhe gjysëm të gatshme të destinuara për eksport.</p> |                                                                                                                                                                            | <p><b>Përrjashtim nga tatim fitimi për investorët për një periudhë 10 vjeçare,</b> nëse:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• <i>ata investojnë në asetet fikse me një shumë që tejkalon rreth 9 milion €, dhe</i></li><li>• <i>të kenë të punësuar të paktën 100 punëtorë të deklaruar</i></li></ul> <p><b>Përrjashtim taksa doganore</b> importin e lëndëve të para dhe gjysëm të gatshme të destinuara për eksport dhe në importin e makinerive dhe pajisjeve për investorët e huaj.</p> | <p><b>Përrjashtim nga tatim fitimi për 3 vitet</b> e para i jepet kompanive të angazhuara në aktivitetet e prodhimit në një zonë të pazhvilluar. (<i>Kjo incen-tivë nuk është e zbatueshme në sektorët e bujqësisë, të transportit, të ndërtimit të anijeve, të çelikut dhe të peshkimit.</i>)</p> | <p><b>Përrjashtim nga TVSH në import për:</b> Mallrat që përpunohen për qëllime eksporti; Pajisjet e IT-së; Makineritë për prodhim; Lëndët e para që futen në process prodhim; <b>Përrjashtim nga taksat doganore</b> për lëndët e para dhe makineritë në prodhim. Kthimi i ak-cizës për lëndë djegëse të harxhuara në proces prodhim <b>Shpenzime të zbritshme për qëllime të Tati-mit të Fitimit të Korporatave:</b> Shpenzimet e përfaqësimit deri në 10% të fitimit para tatimit, plus 10% të tjera për sponsorizime. Shpenzim i zbrit-shëm prej 10% përtej shpenzimit të zhvlerësimit për makineritë e reja prodhuese në vitin e parë kur makineria është futur në përdorim</p> | <p><b>Reduktim me 30% të taksës së fitimit</b> kur investojnë në pajisje prodhimi më shumë se 50% të fitimeve korrente. <b>Redukim me 50%</b> të tatimit të fitimit kur investon nga fondet e veta 10 mln EUR në mënyrë të vazhdueshme në 5 vite, jo më pak se 2 Mln EUR vitin I-rë. <b>Konsiderohen shpenzime të zbritshme për qëllime tati-more dyfishi i pagës bruto</b> të punonjësve të rinj me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të jetë minimumi 12 muaj me kohë të plotë dhe punonjësi i ri të mos ketë punuar më parë me të njëjtin ta-tim-pagues në 5 vitet e fundit.</p> |
| 2. Zonat Ekonomike | 3 zona në proces                                                                                                                                                                                                                                                                                    | 15 Zona Ekonomike, 3 plotësisht funksionale (Shkup 1, Shkup 2 dhe Shtip) 1 është duke kaluar nëpër procedura të PPP (Tetovë) 11 të tjerë në faza të ndryshme të zhvillimit | 14 zona të miratuara, 12 zona operative                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | N/A                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |

| INCENTIVA                                        | SHQIPËRIA                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | MAQEDONIA E VERIUT                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | SERBIA                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | MALI I ZI | KOSOVA | BOSNJA DHE HERCEGOVINA                                                                                                               |
|--------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|--------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <i>Incentiva fiskale brenda Zonave Ekonomike</i> | <ol style="list-style-type: none"><li>1. 50% e tatimit te fitimit per 5 vitet e para.</li><li>2. Hyrja-dalja e mallrave sipas dispozitave të kodit doganor.</li><li>3. Shpenzime të zbritshme 20% e kapitale vjetore për tre vitet e para.</li><li>4. Furnizimi i mallrave shqiptare në zonë, konsiderohet si furnizim eksporti me shkallë zero.</li><li>5. Zhvilluesi përjashtohet nga taksa e ndikimit në infrastruktura</li><li>6. Ndërtimet përjashtohen nga taksa e pasurisë së paluajtshme për 5 vite.</li><li>7. Zhvilluesi dhe përdoruesi përjashtohen nga taksa e kallimit të pronësisë.</li></ol> | <ol style="list-style-type: none"><li>1. Përrjashtimi nga tatimi mbi fitimin për një periudhe deri në dhjetë vjet nga dita e fillimit të aktivitetit në TIDZ. Në mënyrë që të shfrytëzojnë plotësisht këtë përrjashtim të taksave, investitori duhet ta kete filluarë aktivitetin e biznesit jo më shumë se dy vjet pas marrjes së vendimit zyrtar për fillimin e punës në TIDZ.</li><li>2. Përrjashtimi nga tatimi mbi të ardhurat personale mbi pagat e punonjesve, pavarësisht numrit të të punësuarve, për 10 vjeçarin e parë të aktivitetit në TIDZ;</li><li>3. Përrjashtimi nga TVSH i furnizimeve të mallrave dhe shërbimeve, përveç shitjeve tek konsumatori përfundimtar që kryhen brenda zonës ekonomike.</li><li>4. Përrjashtim nga tatimi mbi vlerën e shtuar të importit të mallrave që do të dërgohen në një zonë ekonomike, me kushtin që mos të shiten për konsum final.</li><li>5. Zbritjet nga tatimi mbi të ardhurat e përgjithshme vjetore. Një kompensim personal vjetor në shumën 87.228 denarë ose 7269 denarë (përrafërsisht €117) në muaj mund të zbriten nga paga. Kompensimi i nënshtrohet indeksimit vjetor.</li></ol> | <ol style="list-style-type: none"><li>1. 0% TVSH për mallrat dhe shërbimet brenda zonave të lira dhe për ato që hyjne në zonë.</li><li>2. Furnizimi me energji dhe gaz me 0% TVSH.</li><li>3. Hyrja dhe dalja e mallrave përjashtuar nga pagesa doganore</li><li>4. Përrjashtim nga taksat lokale</li></ol> |           | N/A    | <p>Përrjashtim nga TVSH në importin e mallrave.</p> <p>Përrjashtim nga detyrimet doganore për importimin e paisjeve për prodhim.</p> |



| INCENTIVA                                           | SHQIPËRIA                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | MAQEDONIA E VERIUT | SERBIA                                                                                                                                                                                                                                                                                                             | MALI I ZI | KOSOVA | BOSNJA DHE HERCEGOVINA |
|-----------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|--------|------------------------|
| <i>Incentiva jo-fiskale brenda Zonave Ekonomike</i> | 1. Shpenzimet për paga dhe kontribute shoqërore të punëdhënësit njihen 150% të vlerës gjatë vitit të parë fiskal. Shpenzimet shtesë për pagat në vitet në vijim njihen si shpenzime me 150% të vlerës.<br>2. Kosto trajnimi njihen shpenzime me dyfishin e vlerës për 10 vite.<br>3. Shpenzime për kërkim & zhvillim njihen me dyfishin e vlerës për 10 vite.                                                    |                    | -                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |           |        |                        |
| 3. Incentiva jo-fiskale                             | <b>Procedurë e asistuar nga AIDA sipas sektorëve dhe vlerës së investimit:</b><br>1. Energjitikë dhe miniera, transport, infrastrukturë, komunikime elektronik, mbetje urbane, për investime ≥ 30 mln EUR;<br>2. Turizëm min 80 vende te reja pune, TEDA ≥ 5 mln EUR;<br>3. Bujqësi dhe peshkim ≥ 3 mln EUR dhe min 50 vende të reja pune;<br>4. Zona me përparësi zhvillimi ≥ 1 mln EUR dhe min 150 vende pune. |                    | <b>Reduktim i kontributit të punëdhënësit për punësime të reja</b> për periudhën 1 Korrik 2014-31 Dhjetor 2017:<br><br>- 1-9 punësime të reja, 65 % ulje<br>- 10-99 punësime të reja, 70 % ulje<br>- Mbi 10 punësime të reja, 75 % ulje.<br><br>Vlerësohet se kjo redukton shpenzime paga për punëdhënësin në 20%. |           |        |                        |

| INCENTIVA | SHQIPËRIA                                                                                                                                                                                                                                          | MAQEDONIA E VERIUT | SERBIA                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | MALI I ZI | KOSOVA | BOSNJA DHE HERCEGOVINA |
|-----------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|--------|------------------------|
|           | <b>Procedurë e veçantë miratimi nga Qeveria dhe shpronësim për:</b><br>1. investime ≥ 50 mln EUR për sektorët më sipër;<br>2. për investime ≥ 10 mln EUR dhe 600 vende pune në zonat me përparësi zhvillimi;<br>3. Për çdo investim ≥ 100 mln EUR. |                    | <b>Grante shtetërore</b> për investimet edhe nga investitorë të huaj, projekte <i>greenfield</i> dhe <i>brownfield</i> në sektorin e manufakturës dhe për tregti ndërkombëtarë që variojnë nga 150.000 EUR deri në 600.000 EUR e kostos së investimit ose mbulimi i kostove të punësimeve të reja në lidhje me investimin për një periudhë 2-vjeçare. Ndarja e fondëve sipas kritereve:<br>1. Nivelit të zhvillimit ekonomik të rajoneve;<br>2. Vendeve të punës te reja nga Min 20 – 50 sipas rajoneve.<br><br>Për sektorët me intensitet të lartë pune, grantet mund të rriten progresivisht (me 10%, 15%, 20%) për punësime të reja (mbi 200, 500 dhe 1000). |           |        |                        |

| INCENTIVA                                             | SHQIPËRIA | MAQEDONIA E VERIUT                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | SERBIA                                                                                                                                                                            | MALI I ZI | KOSOVA | BOSNJA DHE HERCEGOVINA |
|-------------------------------------------------------|-----------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|--------|------------------------|
| <b>4. Incentiva Sektoriale</b><br><br><i>Bujqësia</i> |           | <p>66 vende në dispozicion në 6 komuna</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Çmimi i ofertave Fillimi prej € 1 / m<sup>2</sup></li><li>• Çmimi i ofertave Fillimi prej € 0,1 / m<sup>2</sup> për 99 vit qira</li><li>• Madhësia mesatare lokacioni: 3.000 m<sup>2</sup> - 4.000 m<sup>2</sup></li><li>• Ndihma shtetërore në formën e bashkëfinancimit në dispozicion</li></ul> <p><b>Tatimi mbi të ardhurat:</b> Për personat që kryejnë aktivitetet bujqësor si profesion primar, përjashtimet e taksave në vijim janë të lejuara:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Deri në 300.000 denarë (të ardhura), ata kanë të lejuara 100% shpenzime shpenzimeve të standardizuara dhe</li><li>• Nga 300.001 deri në 1.300.000 dinarë (të ardhurave), ata janë të lejuar 80% të shpenzimeve të standardizuara.</li></ul> <p>Për personat që kryejnë veprimtarinë bujqësore si profesion shtesë, shpenzimet e standardizuara janë përcaktuar në shumën prej 80% nga të ardhurat e realizuara.</p> | <p>a) Pagesa direkte nga 80.000 EUR – 160.000 EUR.</p> <p>b) Incentiva të dedikuara për zhvillim rural.</p> <p>c) Incentiva specifike për asistencë teknike dhe profesionale.</p> |           |        |                        |

| INCENTIVA      | SHQIPËRIA | MAQEDONIA E VERIUT                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | SERBIA | MALI I ZI                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | KOSOVA | BOSNJA DHE HERCEGOVINA |
|----------------|-----------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------|------------------------|
| <i>Turizmi</i> |           | <p>Reduktimi i TVSH për turizmin nga 18% në 5%</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Tërheqja e investitorëve të huaj për ndërtimin e hoteleve &amp; objektet turistike</li><li>• Pa pagesë zonat e zhvillimit të turizmit</li><li>• Subvencionet për Operatorë Turistikë si më poshtë:</li></ul> <ul style="list-style-type: none"><li>- Në varësi të vendeve nga vinin turistët, për çdo turist operatori turistik përfiton nga 10-25 EUR;</li><li>- Për transportin e turistëve me tren, operatori përfiton 15 EUR për turist;</li><li>- Për transport të kombinuar (guida turistike) nga 10-15 EUR për turist.</li></ul> |        | <p><b>Përjashtim i TVSH</b> në import për produktet dhe shërbimet për ndërtimin e hoteleve me 5 yje.</p> <p><b>Reduktim i taksës së pa-surisë</b> me 30% për hotelet me 4 yje dhe 70% për hotelet me 5 yje.</p> <p><b>Mbështetje me grante</b> për Veriun e Malit të Zi për investime në turizëm minimum 500.000 EUR dhe min 20 vende pune brenda 3 viteve (ndërtimi i hoteleve mbi 3 yje)</p> |        |                        |

# SHTOJCA 3

## KUADRI LIGJOR MBI INVESTIMET NË SHQIPËRI

Shqipëria ka adoptuar një legjislacion liberal në fushën e investimeve me qëllimin për të mundësuar rritjen e investimeve të huaja direke (IHD). Më poshtë jepet një përmbledhje e ligjeve kryesore në fushën e investimeve, së bashku me incentivat konkrete të parashikuara për investitorët.

### KUADRI LIGJOR MBI INVESTIMET NË SHQIPËRI

| LIGJI                                                   | KONTEKSTI                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | INCENTIVAT/AVANTAZHET                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
|---------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| LIGJI NR. 7764 DATË 02.11.1993 “PËR INVESTIMET E HUAJA” | <ul style="list-style-type: none"><li>Ligji ofron garanci për të gjithë të huajt (qofshin persona fizikë ose juridikë) që janë të gatshëm për të investuar në Shqipëri. Ligji lejon 100% pronësinë e huaj të kompanive. Garanton mbrojtje specifike për investitorët e huaj.</li><li>IHD lejohen dhe trajtohen në pozita të barabrata me investimet e brendshme. Gjithashtu blerja e pronës private të banimit është e lejuar për investitorët e huaj. Investitorët e huaj nuk mund të blejnë tokë bujqësore të cilat mund të merren me qira vetëm për deri në 99 vjet, ndërsa pronat e tjera me natyrë tregtare mund të blihen vetëm nëse investimi është me vlerë sa trefishi i çmimit të tokës.</li></ul> | <ol style="list-style-type: none"><li>Asnjë autorizim paraprak nuk është i nevojshëm për investime të huaja. Nuk ka kufizime të sektoriale;</li><li>Nuk ka kufizim lidhur me kuotat/aksionet e investitorëve të huaj në një kompani (100 % pronësia e huaj është e mundur);</li><li>Investimet e huaja nuk mund të shpronësohen ose shtetëzohen direkt ose indirekt, me përjashtim të rasteve të veçanta kur kjo është në interes të publikut dhe sipas ligjit;</li><li>Investitorët e huaj në parim kanë të drejtë për të transferuar jashtë të gjitha kapitalet dhe kontributet në natyrë;</li><li>Në të gjitha rastet, investitorët e huaj marrin trajtim të barabartë dhe të paanshëm dhe do të ketë mbrojtje të plotë;</li><li>Në çdo rast investimet e huaja do të ketë një trajtim të barabartë në përputhje me praktikat e njohura ndërkombëtare;</li><li>Mbrojtja e veçantë e shtetit nëpërmjet zëvendësimit me të drejta të plota të investitorëve të huaj në konfliktin juridiko-civile me palë të treta private<sup>1</sup>.</li></ol> |

<sup>1</sup> Në vitin 2010 Ligji pësoi disa ndryshime [Ligji Nr. 10316 datë 16.09.2010] me anë të të cilave synohej që investitorëve të huaj t’iu jepej mbrojtje e posaçme në fushën e konflikteteve të pronësisë që mund të kishin me palë të treta. Parashikohej se mbrojtja e veçantë e shtetit iu jepej investitorëve të huaj në rastet kur, për shkak të konflikteve gjyqësore me palë të treta private, pengohej realizimi i investimeve të huaja apo i ushtrimit të veprimtarisë ekonomike. Duke i dhënë statusin e mbrojtjes së veçantë, shteti zëvendësonte investitorin e huaj në procedurat gjyqësore me palë të treta privat. Mbrojtja e posaçme shtetërore sipas këtyre parashikimeve u dha deri më 31 dhjetor 2014.

|                                                                                                                                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| LIGJI NR. 55/2015 “PËR INVESTIMET STRATEG-JIKE”                                                                                                         | <p>Ligji parashikon si investime strategjike, investimet private, publike ose publiko-private, në sektorët:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>Energjia dhe minierat;</li><li>Transporti, Telekomunikacionit, infrastruktura dhe mbetjet urbane;</li><li>Turizmi;</li><li>Bujqësia dhe peshkimi</li><li>TEDA</li></ul> <p>Procedura të qarta për investitorët me qëllim për të lehtësuar dhe përshpejtuar procedurat e tyre administrative. AIDA është struktura përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve administrative për investitorët në një “dritare unike”. AIDA kryen rolin e agjentit ndihmës - procedurat administrative deri në realizimin e projektit të investimit, nëpërmjet një prej procedurave të mëposhtme “procedura e asistuar” ose “procedura e veçantë”.</p> | <p><b>A. Procedura e asistuar</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>Kryerje e veprimeve përgatitore, përgatitje e dokume nteve dhe aplikim administrativ me procedurë të përshpejtuar nga agjenti asistues, përfshirë dokumentet e nevojshme që shoqërojnë aplikimin, kur ato lëshohen nga një organ i administratës shtetërore, me kërkesë të një organi tjetër të administratës shtetërore;</li><li>Trajtim me prioritet të përgatitjes së dokumentacionit, dhënies së mendimeve apo ndjekjen e procedurave të cilat përfshihen në fushën e veprimtaris së organeve të administratës shtetërore, të përfaqësuar në grupin operacional, për përgatitjen dhe realizimin e investimit strategjik;</li><li>Konsolidim i tokës;</li><li>Programe mbështetëse;</li><li>Mbështetje me infrastrukturë ndihmëse;</li><li>Vënie në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore për zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjike.</li></ul> <p><b>B. Procedura e veçantë</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>Shpronësimi e pasurive të paluajtshme, pronë private, për të mundësuar zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjike;</li><li>Miratimi nga ana e Kuvendit, kur vlerësohet nga Këshilli i Ministrave, të kontratave përkatëse të investimit strategjik, me kërkesë të investitorit strategjik për të rritur sigurinë e marrëdhënies juridike të rregulluar përmes tij dhe shtetit shqiptar.</li></ul> |
| TEDA - LIGJI NR. 9789 DATË 19.07.2007 “PËR KRIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ZONAVE TË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK” NDRYSHUAR ME LIGJIN NR. 54/2015. | <p>Të gjitha emërtimet e mëparshme “zona ekonomike”, “zona e lirë” dhe “parqet industriale” zëvendësohen me TEDA</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | <ol style="list-style-type: none"><li><b>Parashikueshmëria</b><ul style="list-style-type: none"><li>Shërbime qeveritare në një “dritare unike” për zhvilluesit dhe përdoruesit Teda</li><li>Afat të gjatë për marrjen me qira të TEDA</li><li>Arbitrazh ndërkombëtar</li></ul></li><li><b>Produktiviteti</b><ul style="list-style-type: none"><li>Infrastruktura e besueshme është krijuar dhe vendosur në dispozicion të TEDA</li><li>Sigurimi i përpunimit pasiv për produktet TEDA</li><li>Incentiva fiskale për zhvillimin-kërkim dhe trajnimin e fuqisë punëtore</li></ul></li><li><b>Përfitueshmëria</b><ul style="list-style-type: none"><li>Përrjashtime nga taksat doganore dhe nga TVSH në lidhje me mallrat, lëndët e para dhe makineri për zhvilluesit, përdoruesit dhe operatorët e TEDA.</li><li>Incentiva fiskalë dhe përjashtime nga tatami mbi të ardhurat dhe mbi ndërtesat për të minimizuar kostot fillestare.</li><li>Incentiva fiskale për rritjen e punësimit</li></ul></li><li><b>Incentiva specifike</b> të cilat mund të ndahen në incentive fiskalë dhe administrative apo proceduralë sikurse janë paraqitur në <i>Tabelën “Matrica e Incentivave”</i>.</li></ol>                                                                                                                                                                                                                                                                     |

Përveç ligjeve të mësipërme të veçanta që synojnë kryesisht investitorët, Qeveria ka inkorporuar edhe ligje sektoriale, siç janë Ligji “Për Turizmin”, Ligji “Për Koncesionet dhe PPP”. Incentiva të tjerë të rëndësishëm janë përfshirë në legjislacionin aktual, si përjashtimi nga pagimi i TVSH i importit të makinerive të destinuara për investime në vlerë prej të paktën 50 milion ALL.

## RRETH KËSHILLIT TË INVESTIMEVE NË SHQIPËRI

Këshilli i Investimeve ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. Kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që promovojnë mirëfunksionimin e tregut.

**Dr. Diana Leka (Angoni)**

Drejtoresh e Sekretariatit  
lekad@investment.com.al

**Elvis Zerva**

Ekspert Ligjor dhe Rregullator  
zervae@investment.com.al

**Elida Fara**

Eksperte Ekonomike  
farae@investment.com.al

**Xaira Shurdha**

Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin  
shurdhax@investment.com.al

**Elisa Lula**

Oficere Administrative dhe Komunikimi  
lulae@investment.com.al

**Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI),** Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri  
info@investment.com.al / [www.investment.com.al](http://www.investment.com.al) / SKI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.

 Albania Investment Council  ALInvestCouncil  Albania Investment Council